



VENDIM

Nr. 126 Datë 02.12.2011

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9, 13 pika 1 gërma “ç”, 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “P”, 5 pika 1 gërma “P”, 13 dhe 14, pika 1, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.12.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

- Aplikimi i shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave.
- Në datën 01.11.2011 me shkresën nr. 417/1 Prot., rezultoi e paraqitur një ankesë jashtë afatit 2 – mujor të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të ERE-s, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k, për liçensim në aktivitetin e Tregut të Energjisë Elektrike.
- Ankesa e sipërcituar është jashtë objektit të këtij liçensimi dhe nuk prek aspak vendimmarrjen e ERE-s mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, të shoqërisë “Balkan Green Energy”.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “Balkan Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.